



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulv: "Zhan D'Ark". Nr. 2  
1001, Tirana – ALBANIA

Tel: + 355 4 380 300

+ 355 4 380 333

Faks: + 355 4 379 826

E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

Web-site: [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. 122 Prot.**

**Tiranë, më 23/05/2008**

**Lënda:** *Dërgohet Raporti i veçantë Nr.1*

**Drejtuar:** **Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë**

**Zj. Jozefina TOPALLI (ÇOBA)**

**Tiranë**

**E nderuar zj. Kryetare,**

Raporti i veçante, qe kam nderin t'Ju prezantoj eshte i pari qe paraqet Institucioni i Avokatit të Popullit. Ky raport bën fjalë për nevojën dhe urgjencën e botimit në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar.

Ky raport bazohet ne nenin 27 te Ligjit Nr.8454 date 04.02.1999 "Per Avokatin e Popullit", te ndryshuar, ku parashikohet se :

*"Perveç raportimit ne kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund te raportoje para Kuvendit me nismen e tij ose me kerkesen me shkrim te Kryetarit te Kuvendit ose te nje grupi deputetesh. Kryetari i Kuvendit vlereson nese ky raportim do te behet:*

- a. ne seance plenare;*
- b. me shperndarje te raportit;*
- c. ne komisionet e perhershme te Kuvendit;*

*Edhe në këto raste, kopje të këtij raporti i dërgohen Presidentit të Republikës, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në raport".*

Sugjerimi ynë është që ky Raport i veçantë të shqyrtohet në një seancë të vetme në Komisionet e përhershme të Kuvendit me pjesëmarrjen e deputetëve të të katër Komisioneve: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisionit për Integrimin European; Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Komisionit për Ekonomine dhe Financat. Kjo për arsye se janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integritit dhe ajo e Financave janë dikasteret që do të duhet të bashkëpunojnë që të realizohet detyra e botimit dhe publikimit të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shtetit Shqiptar.

Lutemi që, pasi të vendosni se si dhe para kujt do të shqyrtohet ky Raport, të njoftohemi për t'u paraqitur.

**Me respekt**

**AVOKATI I POPULLIT**

**Ermir DOBJANI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**

---



# **RAPORT I VEÇANTE**

## **Nr.1**

**Për botimin në Fletoren Zyrtare të**  
**Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar**

**2008**

## 1. Objekti, qëllimi dhe baza ligjore e Raportit të veçantë “Për botimin në Fletoren Zyrtare të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar”

Qëllimi i këtij raporti është nxjerrja në pah e rëndësisë që paraqesin për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, aktet ndërkombëtare të ratifikuara si dhe venia në levizje të institucioneve kompetente për të kryer detyrat e tyre për botimin në Fletoren Zyrtare të teksteve të perkthyer në gjuhën shqipe të të gjithë këtyre akteve ndërkombëtare, të ratifikuara nga vendi ynë, para dhe pas vitit 1990.

Duke patur parasysh faktin se Shqipëria tashmë ka nënshkruar aplikimin për t’u pranuar në një të ardhme në Bashkimin Evropian, Avokati i Popullit ka synuar që, nëpërmjet veprimtarisë së tij, të garantojë zbatimin e shtetit ligjor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Institucioni ynë, për më tepër se 6 vite nuk ka arritur që të bëjë të mundur që institucionet kompetente të shtetit shqiptar të realizojnë detyrimin kushtetues që marrëveshjet ndërkombëtare që ka ratifikuar shteti shqiptar të botohen të perkthyer në gjuhën shqipe në Fletoren Zyrtare.

Sipas nenit 63 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”.

Gjithashtu ky raport bazohet edhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Përveç raportimit në kushtet e nenit 26, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetesh. Kryetari i Kuvendit vlerëson nëse ky raportim do të bëhet:*

*d. në seancë plenare;*

*e. me shpërndarje të raportit;*

*f. në komisionet e përhershme të Kuvendit;*

*Edhe në këto raste, kopje të këtij raporti i dërgohen Presidentit të Republikës, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, si dhe organit më të lartë epror, vartësit e të cilëve janë përmendur në raport”.*

Sugjerimi ynë drejtuar Kryetares së Kuvendit është që ky Raport i veçantë të shqyrtohet në një seancë të vetme në Komisionet e përhershme të Kuvendit me pjesëmarrjen e deputetëve të të katër Komisioneve: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisionit për Integrimin Evropian; Komisionit për Politikën e

Jashtme dhe Komisionit për Ekonomine dhe Financat. Kjo për arsye se janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integritimit dhe ajo e Financave dikasteret që do të duhet të bashkëpunojnë që të realizohet detyra e botimit dhe publikimit të akteve ndërkombëtare.

Besojmë se Kuvendi i Shqipërisë do ta konsiderojë dhe perdore kete raport te veçante si mjet, i cili do te bëjë të mundur analizën e gjendjes në këtë fushë, do t'u kërkojë llogari dhe do të ushtrojë “presion” ndaj organeve kompetente, pergjegjese per te permbushur detyrimin kushtetues te botimit ne Fletoren Zyrtare te gjitha teksteve te Konventave te ratifikuara.

## **2. Raporti midis te drejtes se brendshme dhe asaj nderkombetare ne baze te Kushtetutes se Republikës së Shqipërisë të vitit 1998**

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Europë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, jane angazhimet kryesore aktuale te vendit tone, sipas Marreveshjes se Stabilizim Asocimit, nënshkruar në Maj 2006.

Procesi i nënshkrimit dhe ratifikimit te marreveshjeve nderkombetare dhe perafimit te legjislacionit tone me standartet e kerkuara ne aktet nderkombetare, i ka fillimet në kohë që pas miratimit te Dispozitave Kushtetuese, konkretisht me Ligjin Nr.7491, date 29.04.1991 “Per dispozitat kryesore Kushtetuese”. Ne kete akt, konkretisht ne nenin 16 te tij, parashikohej se nje nder kompetencat kryesore te Kuvendit ishte ratifikimi i traktateve ose marreveshjeve qe kishin te benin me te drejtat dhe detyrat themelore te shtetasve. Njëkohësisht, te drejten per te lidhur traktate e ka patur edhe Presidenti i Republikës, por vetëm per ato traktate qe nuk ratifikoheshin nga Kuvendi.

Kushtetuta jone e miratuar ne 28 nentor 1998, parashikon ne nenet 5, 116 dhe 122 te saj se Republika e Shqipërisë zbaton te drejten nderkombetare te detyrueshme per te, duke i rradhitur marreveshjet nderkombetare te ratifikuara, ne hierarkine e akteve normative qe kane fuqi perpara ligjeve dhe si akte që bejne pjese ne sistemin e brendshem juridik.

Kjo Kushtetutë e ka zgjidhur qartazi raportin midis akteve nderkombetare dhe akteve te brendshme. Keshtu ne pjesen e shtatë te Kushtetutes percaktohet hirerarkia e akteve normative qe kane fuqi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Marreveshjet nderkombetare

te ratifikuara zene vendin e dyte ne hierarkine e tyre. Natyrisht Kushtetuta qendron ne krye te akteve normative dhe ruan superioritetin e vet mbi te gjitha aktet e tjera normative, pra dhe mbi marreveshjet nderkombetare te ratifikuara.

Gjithashtu eshte e qarte nga permbajtja e neneve 116 dhe 122/2 te Kushtetutes se ne hierarkine e normave ato ruajne superioritetin mbi ligjet, dhe, nese ka kundërshti midis ligjit te brendshem dhe marreveshjes nderkombetare te ratifikuar me ligj, do te gjeje zbatim kjo e fundit. Kjo behet plotesisht e mundur, pasi Kushtetuta jone ka përcaktuar qe ajo te zbatohet ne menyre te drejtperdrejte, pervec rasteve kur nuk eshte e vetzbatueshme, por kerkohet nxjerrja e nje ligji. Nderkohe, ne fushen e te drejtave te njeriut, Kushtetuta jone ka futur drejtperdrejte ne veprim Konventen Europiane te te Drejtave te Njeriut duke e bere ate pjese te saj kur thekson se “kufizimet e te drejtave dhe lirive nuk mund te tejkalojne ne asnje rast kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane te te drejtave te Njeriut” (neni 17, pika 2 e Kushtetutës). Por Kushtetuta jone parashikon edhe qe marreveshjet nderkombetare qe ratifikohen me ligj te shpallen dhe te botohen sipas legjislacionit ne fuqi. Vetem pas botimit ne Fletoren Zyrtare marreveshja nderkombetare e ratifikuar behet pjese e brendshme e sitemit juridik.

Ne kendveshtrim te rendesise qe paraqesin marreveshjet nderkombetare te ratifikuara, mosbotimi i nje numri te konsiderueshem te tyre dhe per me teper, i akteve me te rendesishme qe garantojne standartet e duhura per mbrojtjen e te drejtave te njeriut, perben nje mangësi të madhe, sidomos ne drejtim te angazhimeve te marra persiper nga vendi yne. Ne kete menyre, nuk mund te arrihen objektivat e caktuara, te cilat synojne ne fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës, fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efikasitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit, pa nje njohje te sakte te akteve nderkombetare në përgjithësi dhe, atyre per te drejtat dhe liritë themelore të njeriut në veçanti.

Ne kete kuptim, Institucioni i Avokatit te Popullit, çmon se eshte shume i rendesishem botimi i teksteve te te gjitha akteve nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne, para dhe pas vitit 1990 te cilat jane bere pjese e legjislacionit tone te brendshem dhe, si rrjedhim, jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga institucionet e shtetit shqiptar, ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise.

### 3. Rendesia e botimit te teksteve te perkthyer te akteve nderkombetare te ratifikuara ne Fletoren Zyrtare

Botimi i tektit zyrtar të marreveshjes ndërkombëtare të ratifikuar është: **së pari:** një detyrim kushtetutes, sepse në bazë të nenit 117/3 të

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit”*. Kurse neni 122/1 i Kushtetutës sonë parashikon se:

*“Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brëndshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...”*.

**Së dyti:** theksojmë se është e rëndësishme që përmbajtja e këtyre akteve duhet t’i bëhet e njohur si organeve që kanë për detyrë t’i zbatojnë ato, ashtu dhe shtetasve shqiptarë si subjektet që nuk mund të përfitojnë prej tyre, pa u njohur me to. Zbatuesit e drejtperdrejte te ligjit, siç janë gjyqtarët, prokurorët, officerët e policisë etj, ne menyre qe te shmangin shkeljet e te drejtave te njeriut te garantuara nga Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut, duhet t’i njohin aktet ndërkombëtare ne gjuhen zyrtare shqipe dhe, me pas t’i aplikojne ne menyren e duhur.

Detyrimi per botimin ne Fletoren Zyrtare i akteve nderkombetare te ratifikuara është edhe Rekomandim i drejtperdrejte i Keshillit te Europes. Konkretisht, Rekomandimi Nr. (2000)13, i botuar ne Fletoren Zyrtare Extra, Korrik 2007, bën fjalë për publikimin dhe shpërndarjen e tekstit të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Tashme, se fundmi, ky botim është realizuar në Fletoret Zyrtare Extra. Nr.28 dhe 29, në Maj 2008.

#### 4. Organet kompetente dhe procedura e parashikuar ne ligj dhe akte nenligjore nga momenti i ratifikimit te marreveshjeve nderkombetare deri ne botimin e tyre ne Fletoren Zyrtare

Objekti i ketij raporti eshte pikerisht realizimi i botimit te tekstit zyrtar te marrëveshjeve ndërkombëtare te ratifikuara nga vendi yne. Per te realizuar kete, natyrisht duhet ndjekur procedura e parashikuar ne ligje dhe në aktet nenligjore qe sot jane ne fuqi. Pavaresisht se aktet e pabotuara i perkasin kryesisht periudhes para vitit 1998, detyrimi i organeve per te vepruar tani duhet te perputhet me kompetencat e secilit prej tyre.

Ne baze te Ligjit Nr.8371 date 09.07.1998 “Per lidhjen e traktateve dhe marreveshjeve nderkombetare”, procedura nga momenti i depozitimit te traktatit, marreveshjes dypaleshe ose shumepaleshe është si me poshte:

1. Traktati ose marreveshja depozitohet ne Ministrine e Puneve te Jashtme.

2. Ministria e Puneve te Jashtme i paraqet Keshillit te Ministrave aktet (relacion, projekt-ligj ose projekt-vendim) per ratifikim, aderim ose miratim brenda nje muaji nga dita e depozitimit te ketyre te fundit.
3. Keshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit projekt-ligjin se bashku me relacionin perkates per ratifikim ose aderim per traktatet te cilat kane klauzolen e ratifikimit a te aderimit nga Kuvendi apo miraton marreveshjet qe permbajne klauzolen e miratimit nga Qeveria.

Pra ne baze te ketij ligji eshte Ministria e Puneve te Jashtme, e cila depoziton tekstin zyrtar prane Keshillit te Ministrave. Nga praktika e punës që zbatohet rezulton se ky tekst pergatitet nga Ministrite qe lidhen me aktin konkret dhe eshte Ministria e Jashtme qe e kontrollon edhe njehere perkthimin, i cili duhet te behet nga nje perkthyes i njohur dhe firmosur dhe vulosur nga Drejtori i Marredhenieve me Jashte i Ministrise perkatese.

Menyra e realizimit te perkthimit zyrtar aktualisht parashikohet ne Udhezimin e perbashket te Ministrit te Drejtesise dhe Ministrit te Financave nr.3165, date 12.05.2004, *“Per kriteret dhe procedurat e perzgjedhjes se perkthyesve te jashtem dhe tarifat e perkthimit zyrtar qe duhet te paguajne te tretet “*.

Ne piken 8/1 te tij parashikohet se:

*“Shpenzimet e perkthimit qe kryhen nga institucionet e tjera perballohen nga fondet e ketyre te fundit dhe si perkthyes do te zgjidhen vetem ata persona qe jane perzgjedhur nga Ministria e Drejtesise”.*

Aktualisht Ministri i Drejtesise, me Urdherin Nr.6953, date 02.11.2007 *“Per miratimin e listes dhe kontraktimin e perkthyesve te autorizuar per perkthimin zyrtar per vitin 2007-2008”*, ka miratuar listen e 66 perkthyesve te autorizuar per perkthimet zyrtare per 19 gjuhe ne Republiken e Shqiperise.

Referuar Ligjit nr. 8678 date 14.05.2001 *“Per organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise”*, ne nenin 12 të tij parashikohet ngritja dhe kompetencat e Sektorit te Perkthimit Zyrtar. Sektori i Perkthimit Zyrtar ne Ministrine e Drejtesise, pervec perkthimit te akteve te nxjerra prej Ministrise se Drejtesise, qe kane te bejne kryesisht me bashkepunimin gjyqesor nderkombetar, realizon certifikimin e teksteve te akteve nderkombetare, pasi te jene perkthyer prej perkthyesit zyrtar, të angazhuar nga institucioni (ministria e fushes etj). Natyrisht qe përkthyesi duhet të paguhet nga vete institucioni sipas parashikimeve te bera ne udhezimin e mesiperm.

Ne situaten ne te cilen ndodhemi, ne rast se ne Kuvendin e Shqiperise nuk gjenden te depozituara tekstet ne shqip te marreveshjeve nderkombetare te ratifikuara, atehere detyrimi per t'i perkthyer keto marreveshje i perket Ministrise që eshte ne krye te asaj dege te

administrates sipas fushes qe bën fjalë akti nderkombetar. Me pas, eshte detyre e Sektorit te Perkthimeve ne Ministrine e Drejtesise qe te çertifikoje perfundimisht perkthimin zyrtar.

Ne vijim, per te bere te mundur realizimin e botimit ne Fletoren Zyrtare, referuar Ligjit Nr.8502 date 30.06.1999, “Per krijimin e Qendres se Publikimeve zyrtare”, tekstet e akteve te perkthyer duhet te depozitohen ne Kuvend, pasi vetem ky organ (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë) mund t’ja percjelle Qendres se Publikimeve Zyrtare per botim.

#### 5. Veprimtaria e Institucionit te Avokatit te Popullit për të realizuar botimin e teksteve të përkthyer zyrtarisht te akteve nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne

Gjatë punës së tij për zgjidhjen e ankesave apo kërkesave të qytetarëve Avokati i Popullit konstatoi se një numër i madh i akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë, para dhe pas viti 1990, nuk ishin botuar ne Fletoren Zyrtare. Ndër këto mund të përmendim marrëveshjen e ekstradimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ratifikuar që në vitet 30 të shekullit të kaluar. Ndërsa pas vitit 1990 mund të përmendim një ndër aktet ndërkombëtare më themelore, Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut. Veç kësaj, përkthimi për mjaft nga këto akte nuk ishte i çertifikuar zyrtarisht, kështu që për një akt mund të gjeje versione të ndryshme përkthimi.

Prandaj ne vitin 2002, Institucioni i Avokatit te Popullit, ndermori nje studim per te evidentuar, se cilat ishin aktet ndërkombëtare të nënshkruara nga organet përkatëse (Presidenti, Qeveria, Ministrat etj.), sa prej tyre ishin ratifikuar kur ishte i domosdoshëm ky ratifikim dhe cilat prej akteve të ratifikuara (apo të hyra në fuqi pas nënshkrimit), ishin botuar ose jo në Fletoren Zyrtare. Ky studim u vlerësua si i domosdoshëm, pasi u konstatua se nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, një numër shumë i vogël prej tyre ishte botuar në Fletoren Zyrtare si tekst i përkthyer zyrtar së bashku me ligjin që e kishte ratifikuar atë.

Bazuar në nenin 63, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij,*” korrespondenca jone me Institucionet kompetente filloi me nje kerkese per informacion, drejtuar ish Ministres se Punëve të Jashtme Znj. Arta Dade. Objekti i kerkeses tone konsistente ne keto çeshtje:

1. Identifikimin e Konventave, Protokolleve shtesë apo Marrëveshjeve të nënshkruara nga vendi ynë me O.K.B-ne dhe Këshillin e Europës dhe cilat prej tyre ishin ende të paratifikuara;
2. Informimi për aktet ndërkombëtare të cilat ishin ratifikuar nga vendi ynë dhe teksti i tyre ishte botuar në Fletoren Zyrtare;
3. Informimi për aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë teksti i të cilave ishte i pabotuar në Fletoren Zyrtare.

Ne pergjigje të kërkesës tone, më datën 29.03.2002 Ministria e Puneve të Jashtme, pasi vleresonte inisiativen tone si shumë të rëndësishme, shpjegonte se në bazë të nenit 22 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 09.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, se ajo ka për detyrë të depozitojë këto akte dhe t’ja paraqesë ato Këshillit të Ministrave për ratifikim, aderim, ose miratim brenda një muaji pas depozimit dhe ky i fundit, (Këshilli i Ministrave) me pas i paraqet Kuvendit projektligjin, së bashku me tekstin e akteve.

Përsa i përket listës së Konventave, të botuara dhe të pabotuara në Fletoren Zyrtare, ministria na referonte tek Qendra e Publikimeve Zyrtare si institucioni kompetent për dhenien e një informacioni të sakte.

Në vazhdim të trajtimit të këtij problemi, kemi komunikuar me Qendrën e Publikimeve Zyrtare. Objekt i kërkesës drejtuar asaj kanë qenë këto çështje:

1. Informimi për aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, teksti i të cilave është botuar në Fletoren Zyrtare;
2. Informimi për aktet e ratifikuara teksti i të cilave nuk është botuar në Fletoren Zyrtare;
3. Paraqitja e problemeve të ndeshura nga ky organ në procesin e rëndësishëm të botimit të tekstit zyrtar të akteve ndërkombëtare të ratifikuara.

Qendra e Publikimeve Zyrtare, në përgjigjen e saj ndër të tjera shpjegonte se ligjet e miratuara deri në fund të vitit 1998 (deri në miratimin e Kushtetutes) që kanë ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare, nuk janë botuar bashkë me tekstin e marrëveshjeve perkatëse. Vetëm pas miratimit të Kushtetutes në fuqi është bërë botimi i marrëveshjes bashkë me ligjin që e ratifikon.

Gjatë procesit të botimit të këtyre marrëveshjeve, Qendra e Publikimeve Zyrtare, shpjegonte se ka patur vështirësi shumë të mëdha lidhur me përthimin zyrtar. Për të shmangur këto vështirësi, ky organ propozonte zgjidhje, një nga të cilat ishte që, bashkë me ligjin që ratifikon marrëveshjen, Qendres së Publikimeve Zyrtare duhet t’i vihet në dispozicion materiali edhe në mënyrë elektronike, të shkruar sipas rregullave drejtëshkrimore. Në rast se kjo do të realizohej, do të kishte

shpejtesi dhe saktesi ne botimin e te gjitha akteve te detyrueshme per botim.

Pasi analizoi situaten konkrete, ne te gjithe komponentet e saj ligjore dhe praktikë, Institucioni i Avokatit te Popullit konstatoi se konkretisht, në vitin 2002 rezultonte se nga 47 Konventa, Marreveshje, apo Protokolle te Keshillit te Europes te ratifikuara, per 25 prej tyre nuk ekzistonte i botuar teksti zyrtar i perkthyer ne gjuhen shqipe. Ndersa per aktet e O.K.B.-se, nga rreth 87 akte te ratifikuara, nuk ekzistonte i botuar teksti zyrtar i perkthyer per 50 prej tyre.

Ne keto kushte, i rekomanduar organeve pergjegjese te cilat dhe i kishim informuar me pare, Ministrit te Drejtesise dhe Ministrit te Puneve te Jashtme se duhet të zgjidhnim problemin për rreth 75 akte.

Rekomandimi ynë konkret ishte:

*1. Krijimi i nje praktike efçente, ne bashkepunim me Drejtorine e Marreveshjeve Nderkombetare dhe Maredhenieve Juridiksionale prane Ministrise se Drejtesise, ne lidhje me realizimin e perkthimeve zyrtare te akteve nderkombetare te pergatitura per miratim nga ana e organeve kompetente.*

*2. Ne te njejten kohe, të realizohej botimi ne gjuhen shqipe i teksteve te konventave dhe marreveshjeve te ratifikuara nga vendi yne, teksti i te cilave nuk eshte botuar ne Fletoren Zyrtare, per te realizuar njohjen me tekstin e ketyre akteve nga te gjithe organet te cilat jane te detyruara t'i zbatojne ato.*

Ne pergjigje te Rekomandimit tone, Ministria e Puneve te Jashtme, eshte shprehur plotesisht dakort me sugjerimet tona. Nga ana e saj evidentohet se shqetesim mbetet edhe niveli i perkthimit zyrtar te akteve dhe cilesia e botimit te tyre. Vazhdimisht, kjo Ministri i ka kerkuar institucioneve kompetente nje perkthim profesional te akteve si dhe kopje cilesore dhe te qarta te tyre.

Njëkohësisht Ministria e Puneve te Jashtme na informoi se i kishte derguar nje shkrese te gjitha Ministrive, ku percillen sugjerimet e Institucionit te Avokatit te Popullit. Gjithashtu, nepermjet kesaj shkrese, ishte kerkuar dergimi prane Qendres se Publikimeve Zyrtare te teksteve te akteve ne gjuhen shqipe ne diskete, ne momentin qe ato ratifikohen nga Kuvendi. Kjo do te mundesonte botimin e shpejte, cilesor dhe te sakte te tyre ne Fletoren Zyrtare, se bashku me ligjin perkates nga Qendra.

Pra, Rekomandimit te Avokatit te Popullit, derguar ne vitin 2002, i eshte pergjigjur zyrtarisht vetem Ministria e Punëve të Jashtme, në kohën që drejtohej nga zoti Ilir Meta, duke u treguar e gatshme per nje bashkepunim te metejshem me institucionet e tjera kompetente.

Duke u gjendur para mosveprimit për rreth 4 vjet nga organet përgjegjëse lidhur me detyrimin per te botuar ne Fletoren Zyrtare tekstet e

marreveshjeve për të drejtat e njeriut të ratifikuara nga vendi ynë, konstatimet dhe nderhyrjet konkrete janë bërë prezente edhe në Raportet tona Vjetore, të paraqitura në Parlament, duke filluar nga viti 2002 e në vazhdim. Por duke parë se problemi nuk po gjente zgjidhje, edhe për shkak se administratat e dy ministrive, përfshirë dhe Ministrat e Drejtësisë dhe të Punëve të Jashtme ndryshonin thuajse çdo vit, në vitin 2006 rifilluam korrespondencën dhe, pa ndryshuar objektin e kërkesës tonë, ju ridrejtua ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Drejtësisë.

Pas kësaj nga Ministria e Drejtësisë në kohën që drejtohej nga zoti Aldo Bumçi vjen një reagim pozitiv me një propozim konkret. Meqenese bëhej fjalë për një problem të mbartur prej vitesh, pas insistimit të Avokatit të Popullit, Ministria e Drejtësisë, shprehu vullnetin t'i japë një zgjidhje sa më të shpejtë dhe perfundimtare problemit. Kështu, duke theksuar se bëhej fjalë për perkthimin dhe botimin e të paktën 75 akteve nderkombetare, me një kosto financiare prej rreth 2 miliona lekesh, Ministria e Drejtësisë morri përsipër t'i propozonte Ministrisë së Financave shtimin e fondit të mesiperm me këtë destinacion në buxhet gjatë rishikimit të buxhetit të përgjithshëm të shtetit për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2006.

Institucioni i Avokatit të Popullit në pritje të veprimeve konkrete, në shkurt 2007, komunikoi edhe njëherë zyrtarisht me Institucionet perkatese, duke kërkuar të njëjët me veprimet e kryera nga Ministria e Drejtësisë për zgjidhjen perfundimtare të kësaj çështje. Nga pergjigjet e ardhura, konstatoam se situata nuk kishte ndryshuar aspak. Duke insistuar pranë Ministrisë së Drejtësisë, disa here gjatë vitit 2007, perfundimisht u informuam se qëndrimi i këtij Institucioni ka ndryshuar, duke sugjeruar decentralizimin e perkthimit të akteve të papërkthyer nga ministritë dhe institucionet që mbulojnë fushën për të cilën bën fjalë akti nderkombëtar.

Konkretisht, zv.Ministri i Drejtësisë, në dhjetor 2007, në pergjigjen që na jepte ndër të tjera theksonte se:” *Duke marrë në konsideratë detyrimin që institucionet e fushave, të cilat këto akte mbulojnë, kanë pasur për të ndjekur procedurat e sakta të nënshkrimit dhe ratifikimit të këtyre akteve, përfshirë këtu dhe perkthimin, si dhe kompetencat e sotme që Ministria e Drejtësisë vetëm i çertifikon këto akte, mendojme që për ato tekste , të cilat nuk rezultojnë të perkthyer pranë Kuvendit të Shqipërisë, mund të realizohet perkthimi dhe pagesa e këtij shërbim prej ministrive dhe institucioneve kompetente”.*

Gjithashtu, duke qenë se Ministria e Punëve të Jashtme është institucioni depozitar i të gjithë këtyre akteve, nga Ministria e Drejtësisë propozohet që Ministria e Punëve të Jashtme të luajë rolin koordinues për shpërndarjen dhe perkthimin zyrtar të akteve prej institucioneve të fushave perkatese.

Duke përshkruar zhvillimin e problemit si me siper, arrijme ne konkluzionin se midis Institucioneve pergjegjese per realizimin final te ketij procesi, prej të paktën 6 vjetësh janë evidentuar mangesi serioze për koordinimin e punes. Prandaj për ta zgjidhur problemin çmojme se nevojitet qe te ngrihet nje grup pune, i cili te kete ne funksion te tij, se pari, evidentimin e akteve te pabotuara, shperndarjen e tyre prane institucioneve kompetente, sipas fushes se aktit te ratifikuar, çertifikimin e perkthimit nga Sektori i Perkthimeve ne Ministrine e Drejtesise dhe ne perfundim, kalimin e te gjithe materialit ne Kuvendin e Shqiperise, i cili, referuar Ligjit Nr.8502 date 30.06.1999 “Per krijimin e Qendres se Publikimeve Zyrtare” i ndryshuar, duhet t’ja percjelle Qendres se Publikimeve Zyrtare per botim.

Në këtë rast rekomandojmë se Administrata e Kuvendit të Shqipërisë duhet ta drejtojë dhe menaxhojë këtë proces.

#### 6. Aktivitetet e tjera të Avokatit të Popullit per ndergjegjesimin e Institucioneve kompetente per realizimin e botimit ne shqip te akteve nderkombetare te ratifikuara

Veç rekomandimeve konkrete drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim, çdo vit në Raportet Vjetore që ka paraqitur Institucioni i Avokatit të Popullit para Kuvendit të Shqipërisë është bërë fjalë për këtë problem duke kërkuar në këtë mënyrë edhe ndërhyrjen dhe ndihmën e legjislativit për këtë çështje. Në diskutimet e tyre në Kuvend deputetë të veçantë si psh. Z. Paskal Milo, Znj. Arta Dade etj, e kanë prekur këtë çështje, në kohën që nuk kanë qënë ministra. Edhe në Konferencat Kombëtare vjetore që ka organizuar Institucioni i Avokatit të Popullit, në vartësi me temën e Konferencës vjetore si p.sh. per te drejtën e jetës; për të drejtat e punonjësve; për të drejtat e fëmijëve etj, eshte permendur rendesia qe paraqesin aktet nderkombetare te ratifikuara për mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te njeriut, si dhe eshte theksuar domosdoshmeria e botimit ne shqip te Konventave te ratifikuara nga vendi yne.

Ndër të tjera është për t’u permendur mungesa e publikimit te ligjit per ratifikimin e Konventes se Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Femijeve. Ne raportin e Shtetit Shqiptar prane Komitetit te Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Femijeve, cilesohet se kjo Konvente eshte ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise ne Shkurt 1990 dhe ka hyre ne fuqi ne Mars 1992. Ne asnje nga Fletoret Zyrtare te shtetit tone nuk pasqyrohet akti normativ me ane te se ciles shteti shqiptar aderon ne Konventen mbi te Drejtat e Femijeve. Po kështu mungon dhe teksti i Konventes, i perkthyer zyrtarisht ne gjuhen shqipe.

Ne keto kushte, Avokati i Popullit dhe Qendra “Femijet Sot” organizuan me 8 Prill 2008 aktivitetin e perbashket me teme: “Konventat per te drejtat e femijeve dhe çështjet e ratifikimit dhe botimit te akteve nderkombetare ne Shqiperi”. Ne kete aktivitet, ku morën pjesë edhe deputetët Zj. Lajla Pernaska dhe Z. Engjell Bejtaj, u theksua dhe njehere synimi i Institucionit te Avokatit te Popullit per ndergjegjesimin e strukturave perkatese te shtetit shqiptar per rendesine e njohjes dhe botimit te akteve nderkombetare, te ratifikuara nga shteti shqiptar nder vite.

## 7. Rekomandimet e Avokatit të Popullit për të bërë të mundur zgjidhjen e problemit

Ne perfundim te ketij Raporti te Veçante ritheksojme se perkthimi zyrtarisht ne gjuhen shqipe dhe botimi ne Fletoren Zyrtare i teksteve te akteve nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne eshte një proces mjaft i rëndësishëm dhe duhet bërë me urgjencë dhe përparësi. Për këtë rekomandojmë:

1. Ky raport të shqyrtohet në një mbledhje të përbashkët të deputetëve përfaqësues nga Komisioni i perhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisioni për Integrimin European; Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Komisioni për Ekomomine dhe Financat. Në këtë mbledhje të ftohen të marrin pjesë edhe Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Integritimit dhe Ministri i Financave. Mbledhja te kryesohet nga Kryetarja e Kuvendit ose një nga Zëvendësit e saj.

2. Mbledhja të caktojë afat për përfundimin e gjithë procesit dhe të nxjerrë detyrat konkrete të cilat do t'i realizojnë një grup pune, i krijuar me përfaqësues të të gjitha dikastereve të përfshira në këtë proces. Grupi i punës të drejtohet nga Administrata e Kuvendit.

3. Grupi i Punës ndër të tjera duhet të realizojë:

- evidentimin e akteve nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne, teksti i te cilave nuk eshte botuar ne Fletoren Zyrtare;
- Shperndarjen e këtyre akteve institucioneve kompetente sipas fushes se aktit te ratifikuar per perkthimin ne shqip, ose grumbullimin e tyre pranë një strukture që mund të ngrihet pranë Kuvendit të Shqipërisë, të mbështetur me fondet përkatëse për të paguar burimet njerëzore për perkthimin.
- Çertifikimin e perkthimit nga Sektori i perkthimeve ne Ministrine e Drejtësisë dhe,
- Kalimi i te gjithë materialit ne Kuvendin e Shqiperise, i cili duhet t'ja percjelle Qendres se Publikimeve Zyrtare per botim.

4. Në perspektivë, të planifikohet buxheti për të botuar në një përmbledhje të veçantë të gjitha aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar dhe që janë bërë pjesë e së drejtës sonë të brendëshme, me qëllim që si publiku, ashtu edhe organet e zbatimit të ligjit të kenë lehtësi për njohjen e këtyre akteve.

**8. Kopje e dokumentacionit të realizuar nga Zyra e Avokatit të Popullit për të mundësuar botimin zyrtar të Akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar**